



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 2638/prot.
1

Tiranë, më 04.03.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1775, datë 03.11.2015.

SHOQËRISË “MAKARESH” SH.P.K
Lagja Grumbullimit, Rruga e Laçit, Pallat i ri, kati 1, Fushë Krujë
Krujë, Durrës

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “MAKARESH” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1775, datë 03.11.2015, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Makaresh”, Krujë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresat nr.1668/1 prot, datë 28.02.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 2603 prot., datë 28.02.2019 dhe nr. prot. 1834, datë 01.03.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 2646 prot., datë 01.03.2019, është propozuar revokimi i lejes minerare të nr.1775, datë 03.11.2015, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Makaresh”, Krujë, për arsye se:

- Subjekti nuk ka zbatuar projektin e hapjes së objektit minerar për rradhën e Shfrytëzimit nga lart-poshtë sipas projektit të miratuar në Këshillin Teknik pranë AKBN-së dhe si rrjedhojë nuk ka respektuar Ligjin Nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Neni 47, Pika, shkronja “dh”.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “dh”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1775, datë 03.11.2015, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Makaresh”, Krujë, që shoqëria juaj zotëron.**

Duhet të paguani si diferencë rehabilitimi shumën 607090 lekë, pasi nga 968250 lekë që duhet të kishit paguar sipas sipërfaqes së prekur nga shfrytëzimi, keni paguar 361160 lekë.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes së shfrytëzimit nr.1775, datë 03.11.2015, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Makaresh”, Krujë.

Në zbatim të nenit 49. të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

